



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës**

VENDIM

Nr.207, datë 05.12.2011

“Për miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtare
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Anëtare

Në mbledhjen e datës 05.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa d.

KOMISIONI I KONKURENCËS

VËREN SE:

Konkurrenca është një instrument i domosdoshëm për tregun, që sjell rritjen e mirëqenies ekonomike duke krijuar me shume mundësi zgjedhjeje për konsumatorët në një mjedis ekonomik ku ndërmarrjet mund të veprojnë lirisht për arritjen e objektivave të tyre. Për të pasur një ekonomi sa më efikase dhe sa më konkurruese, rol të rëndësishëm luan zbatimi i Ligjit të Konkurrencës dhe i Politikës së Konkurrencës.

Në Republikën e Shqipërisë mbrojtja e konkurrencës realizohet nëpërmjet Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar). Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke mbikëqyrur rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, si një autoritet i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij, në bazë të politikës kombëtare të konkurrencës, ka si një nga objektivat kryesore forcimin e kulturës së konkurrencës në mjedisin shqiptar. Realizimi i këtij objektiwi është një ndër instrumentat e rëndësishme për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës së

lirë dhe efektive në treg. Në këtë kuadër, ndër të tjera, Autoriteti i Konkurrencës, kryen edhe aktivitete të ndryshme publike, botime etj.

Si pjesë e krijimit të imazhit si një institucion i pavarur është e nevojshme edhe miratimi i një steme të veçantë të Autoritetit të Konkurrencës e cila duhet të përdoret në të gjithë aktivitetet publike,botimet etj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24 d):

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, sipas modelit të bashkëlidhur.
2. Kjo stemë do të përdoret në ambientet e institucionit, aktivitetet publike, botimet dhe prezantimet nga i gjithë stafi i Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCES

Servete GRUDA

Antar

Koço BROKA

Anëtar

Rezana KONOMI

Anëtar

Lindita MILO(LATI)

KRYETAR

Stema Zyrtare e Autoritetit të Konkurrencës:

